



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 36/2023 (JR)
Nr. 36/ regj.

Tiranë, më 26.05.2025

**SHPALLJE
E**

NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesmarrës në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar, se sot më datë 26.05.2025, gjatë shqyrtimit mbi bazë aktesh në dhomë këshillimi, të çështjes me numër regjistri (JR) 36/2023, datë 26.07.2023, mbi ankimin e subjektit të rivlerësimit Hyrjet Lamaj, kundër vendimit nr. 668, datë 26.05.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, trupi gjykues bazuar në nenin 51, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi vijimin e gjyimit të kësaj çështjeje në seancë gjyqësore publike, për konstatimin e plotë të situatës faktike, lidhur me mënyrën e krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 94 m², ndodhur në lagjen {***} Vlorë.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në **datën 09.06.2025 ora 10.00**, në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.


Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjykues
Relatore e Çështjes
Gjyqtare
Gjyqtare
Gjyqtar

Albana Shtylla
Natasha Mulaj
Mimoza Tasi
Rezarta Schuetz
Sokol Çomo

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 51, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në faqen e internetit të tij, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE**


ALBANA SHTYLLA